



Prishtinë, 12 nëntor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1316_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Neni 15 dhe Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05 -L-084;
- Dispozitat e Nenit 20 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05-L-052; dhe
- Amendamentin e Marrëveshjes për Furnizim me Ngrohje në mes të KEK Gjenerimi SH.A dhe NQ Termokos SH.A , dorëzuar për aprovim ne ZRRE me datën 24 tetor 2019.

në seancën e mbajtur me datë 12 nëntor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** Amandementimi i "Marrëveshjes për furnizim me ngrohje e lidhur me datën 24.12.2014, nr 252 " në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. dhe NQ Termokos sh.a.

Arsyetim

- o Me datën 27 tetor 2020, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar propozim Amendamentin - "Aneks marrëveshje për caktimin e çmimit të energjisë termike për furnizim me ngrohje", i cili është lidhur mes KEK sh.a. – NQ Termokos sh.a. me datë 14 tetor 2020.
- o Amendamenti i bashkangjitur i përmban katër nene:
 - Neni 1, me të cilin përcaktohet periudha e vlefshmërisë së aneks marrëveshjes –nga data e 15 tetor 2020 deri më 15 prill 2021,
 - Neni 2 , me të cilin ndryshohen 2(dy) paragrafë të Shtojcës IV të marrëveshjes bazë. Ky ndryshim është rrjedhojë e de-rregullimit të gjeneratorit të energjisë elektrike (KEK Sh. A). Me konkretisht, çmimet e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B i referohen çmimit të energjisë elektrike që KEK Gjenerimi i ofron Furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike (FSHU) në vlerën 29.50€/MWh, si dhe kostos shtesë prej 0.31 €/MWh për të mbuluar koston e konsumit të energjisë elektrike në Stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova B (HES), në bazë të metodologjisë së dakorduar paraprakisht mes KEK - NQ Termokos - ZRRE.
 - Nenin 3, me të cilin palët pajtohen që çmimi bazë i rikalkuluar sipas nenit 2 të jetë 29.81 €/MWh.



- Nenin 4, me të cilin palët pajtohen që, për periudhën sipas Nenit 1, çmimi i energjisë termike të jetë në nivelin 1.36 €/MWh ndërsa për kapacitetin elektrik të jetë në nivelin 20.87 €/MWh/h.
 - o Dispozitat tjera të marrëveshjes bazë e nënshkruar me datën 24 dhjetor 2014 dhe aprovuar nga ZRRE me datën 23 dhjetor 2014 me vendimin V_677_2014 mbeten në fuqi.
 - o Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e Amendamentit në fjalë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d.Kryesues i Bordit

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar